



---

**VENDIM**  
**Nr.97 Datë 07.12.2010**

**PËR**  
**PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR**  
**FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUDHEN 1 JANAR –**  
**31 DHJETOR 2011**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma “b”, 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.78, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Vendimit nr.63, date 13.09.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2011”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të dates 07.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2011, si dhe relacionin e Grupit të Punës të ERE-s,

**Vendosi :**

1. Tarifa e energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhen 1 Janar – 31 Dhjetor 2011 do të jetë **1.48 leke/kWh.**
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

